



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr.15

Prishtinë, më 27.05.2015 ora: 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

Procesverbal

i mbledhjes së komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaqi, Shqipe Pantina, Pal Lekaj dhe Jelena Bontic.

Mungoi: Alma Lama dhe Zafir Berisha.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e OSCE-se, BIRN, GIZ, KDI, Lëvizja "FOL".

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina, Mirjeta Heta dhe Flaka Zairi, praktikante në komision nga UNDP.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 30.04.2015;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Procedurën e përgjithshme administrative;**
- 4. Formimi i grupeve punuese për monitorimin e ligjeve;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 30.04.2015;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur me 30.04.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Procedurën e përgjithshme administrative;

Komisioni vendosi që pika tre e rendit të ditës të shtyhet për shqyrtim për mbledhjen e radhës së komisionit.

4. Formimi i grupeve punuese për monitorimin e ligjeve;

Komisioni për këtë pikë të rendit të ditës formoi grupet punuese si në vijim:

Kryesuese e grupit punues për monitorimin e ligjit për administratën shtetërore është caktuar znj. Xhevahire Izmaqi.

Kryesuese e grupit punues për monitorimin e ligjit për OJQ-të është caktuar znj. Shqipe Pantina.

Zenun Pajaziti - rekomandoi që në grupet punuese për monitorimin e ligjeve mund të marrin pjesë anëtarët e komisionit në përbërje të plote.

Propozimi i sipërshtënuar u miratua nga anëtarët e komisionit.

Komisioni vendosi që tryeza për monitorimin e ligjit për përdorimin e gjuhëve në Kosovë, të mbahet me dt. 9 qershor 2015. Këtë tryezë komisioni e organizon në bashkëpunim me OSCE-në.

5. Të ndryshme

Komisioni në këtë pikë të rendit të ditës votoi Raportin vjetor të RTK-së për vitin 2014, të cilin raport nuk e kishte votuar në mbledhjen e dt.20.05.2015, në mungesë të kuorumit.

Raporti u miratua me 4 vota "Për": Zenun Pajaziti, Xhevahire Izmaku, Jelena Bontic dhe Kujtim Pacaku, ndërsa kundër kanë votuar tre anëtarë, Pal Lekaj, Sadri Ferati dhe Shqipe Pantina.

Pas votimit të raportit vjetor RTK-së komisioni nxori rekomandimin si në vijim:

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 67 dhe 72, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 27.05.2015, shqyrtoi Raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2014, dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqet këtë,

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Raporti vjetor i Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2014.
2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Arsyetimi

Në bazë të nenit 21, paragrafi 6, pika 1 dhe të nenit 38.4 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, Radiotelevizioni i Kosovës ia dorëzon Kuvendit raportin vjetor të aktiviteteve jo më vonë se 31 mars, si dhe raportin vjetor për debatin publik dhe të mendimit të Bordit të RTK-së për qëllime orientuese.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 27.05.2015, shqyrtoi Raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës, dhe vlerësoi se i njëjti përmbush obligimet ligjore për raportim dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Mbledhja përfundoi në 14:15.

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit
Zenun Pajaziti**
